



Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Komuna e Dragashit

31 Dhjetor 2010

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Komuna e Dragashit	5
Të përgjithshme	6
Të gjeturat e vitit aktual	7
Të gjeturat e vitit të kaluar	16
Forma të ndryshme të Opinioneve të Auditimit të përdorura nga Zyra e Auditorit Gjeneral në Raportin e Auditimit për vitin 2010	26
Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010	29
Politikat kontabël	31

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000
Pristina
Kosovo
T +381 38 247 771
+381 38 247 801

Për Kryetarin e Komunës Dragash, Kosovë

Raporti mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të Komunës së Dragashit (“Komuna”), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në para për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010, Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme”, dhe me Udhëzimin Administrativ nr 16/2010 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore dhe me Instruksionet administrative Nr. 15/2009, 18/2009 dhe 21/2009, dhe për këtë menaxhmenti përcakton kontrollat e brendshme të nevojshme të mundësojë përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga gabimet materiale.

Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë gabim ose mashtrim. Gjatë bërjes së vlerësimit të riskut, auditori konsideron kontrollin e brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim që të dizajnojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethana, por jo për qëllimin e shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezentimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmia e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të siguruar bazë për mendimin tonë të kualifikuar të auditimit.

Bazat për Opinion të Kualifikuar

1. Edhe pse Komuna ka shpalosur pagesat nga palët e treta në nenin 9 Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në para, nuk mban listë të detajuar të pagesave nga palët e treta. Për shkak të natyrës së shënimeve të mbajtura në sistemet operative dhe të kontabilitetit për pagesat nga palët e treta, si dhe mungesa e kontroleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të verifikojmë plotësinë e pagesave nga palët e treta për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010.
2. Komuna ka shpalosur shumat prej 91 mijë Euro në lidhje me paisjet në Shënimin 27 të pasqyrave financiare, por nuk ka shpalosur pronën dhe objektet. Për më tepër shumat e shpalosura nuk rakordojnë me regjistrimet e Free Balanc-it në SIMFK të pronës objekteve dhe pajisjeve. Për shkak të natyrës së regjistrave, nuk kemi mundur të jemi të kënaqur me kompletimin, korrektësinë dhe vlerësimin e 'PPE-së' së Komunës për 31 Dhjetor 2010 Due to the nature of the records, we were not able to satisfy ourselves with the completeness, accuracy and valuation of the Municipality's PPE as of 31 December 2010.
3. Disa nga shpalosjet e kërkuara sipas Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme" dhe me Udhëzimin Administrativ nr 2010/16 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore nuk janë bërë nga Komuna në përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010. Veçanërisht, Komuna nuk ka shpalosur vlera në pasqyrat financiare lidhur me llogaritë e arkëtueshme të sajë.

Opinion i Kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të shpalosura në paragrafin "Bazat për Opinion të Kualifikuar", pasqyrat financiare të Komunës paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, fakturat e parasë së gatshme të sajë dhe pagesat dhe ekzekutimin e buxhetit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik "Raportimi Financiar Sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme" dhe me Intruksionin Administrativ Nr. 16/2010 për Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore dhe Instruksionin Administrativ Nr. 15/2009, 18/2009 dhe 21/2009.

Theksim i çështjes

Ne i kushtojmë vëmendje çështjeve në vijim:

Mangësitë dhe pasiguritë që ndikojnë në raportimin financiar për pronat, objektet dhe pajisjet e Komunës janë identifikuar si më poshtë:

- Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve të saj.
- Komuna nuk ka një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë.

- Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës për matjen e një pjesë të rëndësishme të pronës, objekteve dhe pajisjeve, Komuna mat artikujt e tillë me vlerën e drejtë të bazuar në një vlerësim të kryer nga një komision i krijuar brenda saj. Komiteti nuk është përbërë nga vlerësues të certifikuar dhe vlerat e vendosura në listë nuk janë mbështetur nga ndonjë raport vlerësimi. Regjistrimi i pasurisë nga ana e Komunës përfshin vetëm mobilie dhe pajisje të tjera të vendosura në ndërtesën kryesore të Komunës dhe nuk përfshin prona të tilla si toka dhe ndërtesat.

Raport mbi Kërkesat të tjera Ligjore dhe Rregullative

Përveç auditimit tonë të pasqyrave financiare, një rishikim i përputhshmërisë ishte planifikuar dhe kryer për të shprehur një përfundim me siguri të kufizuar në se, në të gjitha aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e pasqyruara në pasqyrat financiare janë në pajtim me autoritetet që qeverisin ato. Natyra, koha dhe niveli i punës së përputhshmërisë ishin të kufizuara në krahasim me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme mbi pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një përfundim të bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë rishikimin që të përfitojmë siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni i pasqyruar në pasqyrat financiare janë në pajtim, në të gjitha aspektet materiale, me autoritetet që qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe pyetje, dhe për këtë arsye ofron më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, i cili është në përputhje me punën shumë të kufizuar që kemi kryer në këtë rishikim të përputhshmërisë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për konkluzionet tona

Konkluzion për përputhshmëri

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë auditimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen për si më poshtë:

- a) Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK. Komuna nuk ka zbatuar një program të integruar kompjuterik kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacionin për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë.
- b) Komuna nuk ka zbatuar një sistem gjithëpërfshirës dhe të automatizuar të faturimit dhe nuk mban lista apo llogari të veçanta për të gjithë debitorët e saj në lidhje me taksat e ndryshme. Vetëm mbledhja e parasë së gatshme nga niveli i të hyrave regjistrohen.

- c) Edhe pse sipas Udhëzimi Administrativ 16/2010 llogarite e arkëtueshme kërkohen të shpalosen në pasqyra financiare, Komuna nuk ka bërë ndonjë shpalosje në shënimin 28 në lidhje me të arkëtueshmet.
- d) Komuna nuk mban lista të detajuara të pagesave nga palët e treta. Evidenca e disponueshme edhe kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti i Komunës për tu siguruar se pagesat nga palët e treta janë të paraqitura dhe të menaxhuara në pajtim me legjislacionin përkatës dhe të aplikuar për qëllimet e synuara nga legjislacioni, ishin të limituara.
- e) Ne identifikuam një numër mospërputhesh me Ligjin Nr 02/L-99, nxjerr me Rregulloren Nr.2007/20 e cila rrjedh nga Rregullorja e prokurimit 2003/17 "Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë" (i ndryshuar). Të tilla jo-pajtueshmëri kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit të kërkuara të cilat nuk janë kryer dhe dokumentuar nga Komuna.
- f) Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe është e mundshme që pagesa të parasë së gatshme të kërkohen në të ardhshmen e afërt, Komuna nuk ka hartuar dhe zbatuar asnjë procedurë për informacion të plotë, të saktë dhe të besueshëm për regjistrimin e provisonëve dhe detyrimeve kontingjente.

Grant Thornton

Prishtinë,
08 Prill 2011

Shtesa I

Komuna e Dragashit

Letër Menaxhmenti

Të përgjithshme

Auditimi për 2010

Grant Thornton është emëruar për të ushtruar auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Komunës së Dragashit (“Komuna”) të përgatitura në pajtueshmëri me bazat në para të gatshme SNKSP Raportimi Financiar në Para të Gatshme, për vitin që mbaron me 31 Dhjetor 2010.

Këshilla jonë në këtë dokument kufizohet në konkluzionet e specifikuara në vazhdim dhe e bazuar në plotësinë dhe saktësinë e fakteve të paraqitura më poshtë, pohimeve dhe prezantimeve. Nëse ndonjë prej fakteve, pohimeve apo prezantimeve të përmendura nuk është tërësisht i kompletuar apo i saktë, atëherë është e domosdoshme që ne të informohemi menjëherë, duke qenë se pasaktësia dhe mungesa e plotësisë mund të kenë një efekt material në konkluzionet tona. Për dhënien e këshillës sonë, ne jemi duke u mbështetur në dispozitat relevante të legjislacionit aktual në Kosovë, rregulloreve, interpretimeve juridike dhe administrative të tyre. Këto autoritete i nënshtrohen ndryshimeve, në mënyrë retroaktive dhe/apo prospektive dhe ndryshime të tilla mund të kenë ndikim në vlefshmërinë e konkluzioneve tona. Ne nuk do të azhurnojmë këshillat tona për ndryshimet ose modifikimet e mëvonshme të legjislacionit dhe rregulloreve, ose të interpretimeve juridike apo administrative të tyre.

Pasojat

Ky raport është dizajnuar të përfshijë rekomandime të dobishme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e politikave të kontabilitetit dhe sistemit të kontrollit dhe kontabilitetit të Komunës si dhe në shmangien e dobësive që mund të qojnë në humbje materiale ose në gabime. Është detyrimi juaj të ndërmerri veprimet e nevojshme për korrigjimin e këtyre dobësive dhe në qoftë se ju dështoni të bëni një gjë të tillë, ne nuk do të mbajmë përgjegjësi për humbjet apo gabimet që mund të ndodhin si rezultat.

Përgjithësimi i pasojave

Siç kemi rënë dakord, ju gjithashtu keni pranuar që për arsye të rëndësishme në punën tonë të informacioneve dhe përfaqësimeve që na janë dhënë nga Komuna, drejtuesit e saj, punonjësit apo agentët, ju, përveç rasteve të neglizhencës, keqbesimit ose pakujdesive të paramenduara, nuk do të na mbani përgjegjës ose fajtorë për ndonjë humbje ose të tjera pasoja në qoftë se informacioni i rëndësishëm për punën tonë na është mbajtur apo fshehur me qëllim, ose na është paraqitur në mënyrë mashtruese.

Struktura e raportit

Çdo kategori e vëzhgimeve është e përshkruar në një faqe të veçantë. Për çdo vëzhgim struktura është: të gjeturat, rreziku, rekomandimi dhe komentet e Menaxhmentit.

Të gjeturat e vitit aktual

1 Përgatitja e pasqyrave financiare

Të gjeturat

Informacioni parësor i besueshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është SIMFK. Komuna i regjistron pranimet dhe pagesat në Excel, që nuk janë përdorur për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet të pasqyrave financiare.

Për me tepër, informacioni në vijim që kërkohet të shpaloset në pasqyrat financiare nuk është i regjistruar në SIMFK dhe nuk është pjesë e një programi të integruar kontabiliteti:

- Pagesat nga palët e treta
- Faturat e pa paguara (detyrimet)

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet dhe detyrimet kontingjente.

Si pasojë e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Shënimi 4 "pranimet tjera" nuk rakordohet me nenin 9 " Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave".
- Shënimi 12 'Të hyrat vetanake' nuk rakordohet me nenin 10 "Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit".
- Shënimi 12 'Të hyrat vetanake' dhe 12.1 " Të hyrat vetanake – Taksat Administrative" nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr 2009/20. Komuna nuk e ka kategorizuar burimin e vet të hyrave të përcaktuara me udhëzim, por e ka përdorur kategoritë e saj të brendshme për të shpalosur këtë informacion.
- Shënimi 13. "Grantet dhe ndihmat" nuk është në përputhje me nenin 10 Raporti i Buxhetit dhe Ekzekutimit.

Të gjeturat e vitit aktual (vijon)

Përgatitja e pasqyrave financiare (vijon)

- Shënimi 15 "Përmbledhja e asetëve jo financiare në pronësi të organizatës buxhetore" Komuna ka dështuar të shpalojë pronën dhe objektet në pronësi të saj, por ka shpалosur vetëm pajisjet. Megjithatë, vlera e pajisjeve prezantuar nuk rakordon me vlerat e regjistruara në SIMFK.
- Mund të ketë pagesa të konsiderueshme nga palët e treta, (për shembull kur një palë tjetër si një ministri apo donator i huaj blejnë/kontribuojnë një pasuri për përdorim nga Komuna), që nuk mund të regjistrohen në pasqyra financiare sepse nuk janë regjistruar në SIMFK;
- Llogaritë e arkëtueshme nuk janë paraqitur në detaje në shënimin "Të arkëtueshmet" në pasqyra financiare.
- Edhe pse Komuna ka deklaruar se nuk ka detyrime kontingjente në nenin 16, Shënimi 29 "Detyrimet kontingjente", për shkak të mangësisë së listës krahasuese të çështjeve gjyqësore, ankesave dhe vlerësimeve juridike retrospektive ne nuk ishim në gjendje të testojmë përshtatshmërinë e prezantimeve të tilla.

Risku

Mangësitë në kontrollet e brendshme në lidhje me sistemin e raportimit financiar mund ta ekspozojnë Komunën ndaj rreziqeve dhe gabimeve si në vijim:

- Plotësia, e saktësia dhe prezantimi i informacionit financiar;
- Integriteti i të dhënave;
- Ruajtja e pasurive; dhe
- Mungesa e regjistrimit të pagesave nga palët e treta mund të rezultojë në pasuri/shërbime të përdorura pa qera nga palët e tjera, të ndryshme nga Komuna.

Rekomandim

Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyrat financiare

Komentet e Menaxhmentit

Pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010 janë përgatitë nga SIMFK. Ky sistem paraqet sistemin unik të mbajtjes së evidencave financiare në Republikën e Kosovës dhe aplikohet nga të gjitha organizatat buxhetore. Nga ky sistem jepen informacione të mjaftueshme mbi procesimin ,regjistrimin dhe raportimin e drejtë të qarkullimit të parasë së gatshme.

Bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare janë të dhënat që dalin nga SIMFK.

Të dhënat e paraqitura në pasqyra financiare janë në përputhshmëri të plotë me të dhënat e gjeneruara nga SIMFK. Përveç evidencave të SIMFK-së, komuna mban edhe evidenca tjera në Excel të cilat përdoren për barazime me të dhënat e SIMFK-së dhe për raportime.

Sa i përket shpалosjes së pasurive jo financiare ne kemi paraqit në shpалosje vlerën e pajisjeve të cilat i ka paraqit komisioni për regjistrimin e pasurive. Komuna ka punuar një regjistër mbi pasuritë i cili i është prezantuar auditorit të pavarur. Futja e këtyre të dhënave në sistem duhet të bëhet pas certifikimit të zyrtarit të pasurive.

Të gjeturat e vitit aktual (vijon)

Pagesa nga palët e treta janë pagesa të cilat në pasqyra financiare janë paraqit dhe të njëjtat janë shpalos. Në vitin buxhetor 2010 pagesat nga palët e treta kapin shumën prej 46 mijë euro. Auditorit i është prezantua marrëveshja dhe kjo marrëveshje është paraqit në shpalosje. Kur është vetëm një pagesë nga palët e treta konsiderojmë se nuk ka nevojë për formimin e një regjistri të pagesave nga palët e treta.

Pagesat nga palët e treta janë pagesa të cilat Ministrinë e ndryshme në formë të bashkëfinancimit marrin pjesë në realizimin e projektit të caktuar. Në rastin konkret fjala është për bashkëfinancim të projektit asfaltimi i rrugës për Zym ku MAPL ka marr pjesë në financim me 45.500,00 euro. Këto mjete nuk janë mjete të buxhetit të komunës. Evidencat rreth shpenzimit të këtij participimi ndodhen në MAPL, nga se pagesa është bërë nga llogaria e Ministrisë.

Llogaritë e arkëtueshme nuk janë paraqit në pasqyra financiare, nga shkak se nga programi i tatimit në pronë, për çështje teknike nuk ka qenë e mundur në momentin e dorëzimit të pasqyrave financiare të nxirren të dhënat mbi këtë llogari. Paraqitja e të dhënave pa të dhënat e tatimit në pronë prap do të konsiderohej si veprim jo i saktë. Pas marrjes për shpërndarje të faturave tatimore, janë dhënë në disponim auditorit.

Për shënimin 4,12 dhe 13 ku thuhet se nuk rakordohen me pasqyrën e pranimeve dhe pagesave, konsiderojmë se është një vlerësim jo i drejtë. Ne kemi diskutuar së bashku me ju dhe ndryshimet e natyrës teknike janë kryer në pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare në gjuhën serbe janë përgatit gjatë veprimtarisë audituese dhe janë dhënë auditorit, ndërsa pasqyrat në gjuhën angleze nuk janë punuar. UA për punimin e pasqyrave financiare nuk parasheh obligimin e dorëzimit të pasqyrave në tri gjuhë.

2 Menaxhimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve

Të gjeturat

Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, pajisjeve dhe impianteve në posedim të saj. Ne ishim të pajisur me dëshmi të numërimit fizik të aseteve deri më 31 Dhjetor 2010. Megjithatë, ky numërim nuk ishte krahasuar me asnjë regjistër dhe përfshinte vetëm mobilet dhe disa pajisje të tjera të vendosura në zyrat e ndërtesës kryesore të komunës, dhe nuk përfshinte prona si toka dhe ndërtesa. Gjithashtu Komuna nuk i ka vlerësuar asetet e numëruara, sepse matja e këtyre aseteve është bërë nga një komision i përbërë nga vlerësues jo të certifikuar.

Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë.

Për shkak të natyrës së të dhënave të tilla, Komuna nuk ishte në gjendje të:

- Shpalos informacionin mbi pronën, pajisjet, dhe impiantet në pasqyrat financiare me 31 Dhjetor 2010 si kërkohet sipas Udhëzimit Administrativ 21/2009;
- Edhe pse neve na janë dhënë shënimet kontabël të raportuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar në Kosovë (SIMFK), këto asete përbëhen vetëm për asetet e blera gjatë viteve por jo edhe ato të trashëguara. Ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë plotësinë e këtyre të dhënave; dhe
- Nuk është bërë ndonjë rakordim i informatave të regjistruara në regjistrin kontabël, tabelat e vlerësimit dhe analiza tjera, para aprovimit të këtyre pasqyrave financiare.

Risku

Mungesa e një regjistri gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve e dobëson kontrollin e brendshëm mbi këto pasuri dhe mund të çojë deri te keqpërdorimi i pasurive dhe mos identifikimit të këtyre keqpërdorimeve në kohën e duhur. Për më tepër, menaxhmenti mund të humbasë kohë dhe përpjekje për të identifikuar detajet dhe vlerën e bartur të pasurive gjatë proceseve vendim-marrëse. Komuna mund të mos jetë në gjendje të kontrollojë shfrytëzimin momental të pasurisë së saj nga palët e treta dhe si pasojë mund të mos i mbledhë të hyrat nga qiraja nga këto patundshmëri.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve të saj dhe mungesës së vlerësimit të duhur të aseteve të saj, Komuna mund të mos jetë në gjendje të pajtohet me kërkesat për raportim.

Rekomandimi

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshtë:

- Të mbajë një regjistër gjithëpërfshirës të pronës, pajisjeve dhe impianteve;
- Të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe të certifikuar është e rekomandueshme dhe praktika më e mirë në raste të tilla.

Të kryejë numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe gjendjen e tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe në regjistër.

- Të bëjë përpjekje shtesë në lidhje me vlerën e shtuar dhe kapitalizmin e aseteve.

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

3 Të hyrat

Të gjeturat

- **Sistemi i faturimit.** Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për të hyrat nga tatimi në pronë. Për kategori tjera të të hyrave për të cilat sistemi i faturimit është i nevojshëm nuk është aplikuar. Vetëm arkëtimet nga të hyrat e tilla janë regjistruar.
- **Dobësitë në sistemin e faturimit.** Gjatë vitit 2010 sistemi i faturimit i tatimi në pronë ishte centralizuar dhe komuna nuk mund të rishikojë dhe monitorojë në mënyrë të duhur mbledhjen e të hyrave pasi që ishte bërë në mënyrë automatike nga sistemi i ri. Mund të ndodh që konsumatori ka paguar tatimin në pronë, por shuma e grumbulluar nuk është regjistruar në sistem dhe klienti është ngarkuar me dënim (interes) edhe pse tatimi është paguar në kohë.
- **Arkëtimi i të hyrave.** Përveç tatimit mbi pronën dhe lejeve të biznesit, Menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra të ndarë ose ndonjë listë të të gjithë borxhlinjve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Pa të dhëna të detajuara dhe të mjaftueshme të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë koeficient të saktë të mbledhjes ose të përcjellë në kohë mbledhjen e të hyrave vetanake burimore.
- **Të hyrat nga licencat e biznesit.** Komuna komunikon me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në mënyrë që të marr numrin e përgjithshëm të bizneseve të reja në komunë; këto biznese të reja janë faturuar duke filluar nga viti në vijim. Komuna nuk ka azhurnuar listën ekzistuese për bizneset e ndërprera. Si pasojë, biznese joaktive ose të mbyllura mund të ngarkohen, ndërsa bizneset aktive apo të reja mund të mos ngarkohen me obligimin përkatës kur ato fillojnë operimin.
- **Të hyrat nga qiraja e pronës publike.** Gjatë kryerjes së auditimit të të hyrave nga qiraja në pronën publike (parkingu) ne kemi identifikuar që Komuna nuk ka kontrollë të duhura mbi mbledhjen e këtij lloji të të hyrave.
- **Të hyrat nga tatimi në pronë.** Sipas rregullores së tatimit mbi pronën, të gjitha pronat e identifikuar pas 31 Mars 2010 ngarkohen për komplet vitin, gjersa pronat që identifikohen pas 31 Marsit të vitit aktual ngarkohen në vitin vijues.
- **Të hyrat e regjistruara në kode jo të duhura.** Bazuar në ekzaminimin tonë të dokumenteve burimore në lidhje me të hyra të caktuara, ne kemi identifikuar dallime në mes të kodeve të ndryshme ekonomike.

Risku

Të arkëtueshmet kërkohen të shpalosen në pasqyrat financiare por nuk janë prezantuar drejtë dhe saktë, mungesa e saktësisë dhe plotësisë se tyre do të ndikojë mbi të hyrat që Komuna mund të fitojë. Kontrollë jo të përshtatshme dhe të pamjaftueshme në lidhje me të hyrat, softuerin dhe sistemin e faturimit, rrisin rrezikun e manipulimit të të dhënave dhe keqpërdorim të informacionit. Një sistem i tillë mund të çojë në faturim jo të plotë dhe të hyra jo të plota. Regjistrimi manual dhe mungesa e lidhjes së sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë automatike e ekspozon Komunën ndaj një rreziku gabimi shtesë. Për më tepër, kjo shkakton kosto shtesë për mbajtjen e të dhënave, rishikimin dhe barazimin e informacionit.

Një listë e detajuar dhe e përditësuar e tatim paguesve, bizneseve aktive dhe debitorëve të gjeneruara nga sistemi është me rëndësi të veçantë në situatën e tanishme ku komunat nuk e regjistrojnë secilin transaksion individual në SIMFK. Si pasojë, përveç se për tatimin mbi pronë, Thesari dhe Komuna, nuk kanë një listë të detajuar të gjeneruara nga sistemi i kontabilitetit ose sistemi i faturimit. Si rezultat i kësaj, nuk është e mundur të bëhen rikonsilimet e nevojshme ose analiza sipas debitorëve.

Rekomandim

Ne rekomandojmë që Komuna të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrole të sigurta, efikase dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me sisteme të tilla do ti mundësonte Menaxhmentit monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve të mëdha dhe sigurimin që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë Komunës që:

- Implementimin e një sistemi të faturimit që përfshin detaje të përditësuara për paguesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave. Informatat e tilla duhet të jenë të mundshme vetëm për një numër të kufizuar të personave dhe me autorizimin e Menaxhmentit.
- Të vendosë dhe të kontrollojë tarifatat dhe normat e taksave në sistem në mënyrë qendrore, që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.
- Të ekzistojë një lidhje automatike midis të sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit.
- Të ushtrojë rikonsilime të rregullta në mes të dy sistemeve për të gjitha llojet e të hyrave. Çdo diferencë rikonsilimi duhet të hulumtohet dhe të zgjidhet brenda një afati të caktuar.
- Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operative dhe të bëhen rikonsilime të rregullta në mes tyre, për rastet kur faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operative. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh transaksionesh.

Komentet e Menaxhmentit

Sa i përket këtij rekomandimi, komuna do të mundohet të bëjë realizimin e tij varësisht nga mundësit teknike dhe financiare.

Të gjeturat e vitit aktual (vijon)

4 Shpenzimet

Të gjeturat

Pagat dhe mëditjet

-Në rastet kur një mësues largohet nga puna, duhet së paku një muaj për tu njoftuar zyra e personelit dhe Ministria e Shërbimeve Publike në mënyrë që të reflektohen ndryshimet në listën e pagave. Bazuar në një vonesë të tillë, një mësues mund të marrë pagën edhe pas largimit të tij.

Gjatë ekzaminimit të dosjeve të personelit ne kemi hasur që disa nga dokumentet ne dosje mungojnë:

- Kontrata e punësimit
- Vlerësimi i intervistës së rekrutimit
- Përshkrimi i punës
- Raporti i vlerësimit për punën e bërë në fund të vitit
- Vlerësimi për nevojat e trajnimit
- Certifikata e trajnimeve dhe kurseve
- Forma e pushimit vjetor

Komuna nuk mban shënime mujore mbi pagat ku do te përfshiheshin të gjitha shënimet në detaje për punonjësit. Kjo liste mund të ishte përdorur edhe për rakordimin me pasqyra financiare.

Në fund të vitit 2010 punëtorët e Komunës kanë pranuar mëditje, sipas vendimit të Ministrisë së Financave e aplikueshme për të gjitha komunat. Këto pagesa janë regjistruar në kode të njëjta të pagave, gjersa sipas planit kontabël është një kod specifik (11200) për punë jashtë orari dhe pagesat tjera që nuk janë paga të rregullta.

Mallrat dhe shërbimet

Bazuar në auditimin tonë të transaksioneve dhe aktiviteteve brenda kësaj kategorie ne kemi identifikuar parregullsitë në vijim:

Bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.400-16 datuar me 19.02.2010, vlera prej 900 Euro i është paguar një grupi këngëtarëve për festimin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Për shërbimin e kryer, nuk ka dokumente mbështetëse.

Bazuar në dëshmitë e mbajtura nga nëpunësi përgjegjës lidhur me kilometrat dhe vlerën e litrave të karburantit në vetura, kemi identifikuar që harxhimi i karburantit i disa veturave është më shumë se 20L për njëqind metra.

Shpenzimet për mëditje në vlerë prej 255 Euro dhe 167.20 Euro janë paguar për udhëtime biznesore për pjesëmarrje në Seminare të mbajtura në Budva dhe Gjermani. Për këto shpenzime të paguara, nuk ka pasur dëshmi të bashkangjitur për agjendën e seminareve, as aprovim të shkruar për pjesëmarrësit që kanë qenë prezent në këto seminare.

Të gjeturat e vitit aktual (vijon)

Shpenzimet (vijon)

Transferet dhe subvencionet

Komuna nuk ka zhvilluar politikë të shkruar për kritere të subvencioneve, që do të përmbante kritere dhe procedura për lejimin e subvencioneve, kështu që subvencionet lejohen vetëm në bazë të vendimeve të Kryetarit të Komunës.

Bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.400-18 date 19.02.2010, nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve tek 14 zyrtarë komunalë janë bërë pagesa nga 150 Euro për secilin zyrtarë, në një total prej 2,100. Këto shuma janë paguar si punë shtesë siç ceket në vendim. Nuk ka ndonjë evidence për autorizimin para fillimit të punës, periudha e punëve të kryera, si dhe aprovimi i orëve shtesë për tu paguar. Për më tepër, pagesat nuk janë bërë nga kategoria pagat dhe mëditjet.

Bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-400-30, me kategorinë e subvencionimit vlera e 629 Euro i është paguar librarisë DPT “Dielli” për blerjen e topave kupave, medaljeve, gjithashtu edhe librave për orë letrare dhe ndeshje futbollit të mbajtur në ngjarjen e festimit të Ditës së Pavarësisë. Shpenzimet janë bere në kodin ekonomik 21110 që është i caktuar për subvencionim të entitetit publike që nuk korrespondon me shpenzimet e ndodhura. Tutje, nuk ka dëshmi që ndonjë procedur e prokurimit është bërë për këtë periudhë kur shpenzimet kanë ndodhur.

Bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës Nr 02-400-44 subvencionimi në vlerë prej 993.24 Euro i është paguar personit vullnetar Halil Avdiu nga fshati Zgatar, duke i ndihmuar në renovimin e kulmit të shtëpisë. Vlera e parave i është paguar kompanisë “Sharra Buzes” për trunqje. Shpenzimet janë paraqitur me kode ekonomike 21110 që është për entitete e subvencione publike që nuk korrespondon me shpenzimet e bëra. Kodi adekuat duhet të jetë 22200 transfere për përfitime individuale.

Procedurat e prokurimit

Bazuar në ekzaminimin tonë të dokumentacionit burimor në lidhje me procedurat e prokurimit të aplikuar në Komunë, ne kemi identifikuar parregullsi të caktuara, siç vijon:

Neve nuk na janë ofruar dëshmi të mjaftueshme që ofertuesit dhe fituesi i kontratës janë informuar për rezultatet e tenderit, siç është kërkuar nga neni 29 i Rregullores B të Prokurimit Publik. Nëse Komuna dështon në përmbushjen e procedurave të parashikuara nga ligji për prokurim Publik (“LPP”) dhe Rregullorja B e prokurimit publik, është e ekspozuar ndaj riskut të transparencës dhe ndërprerjes së aktivitetit të prokurimit nga ndonjë ankesë e operatorit ekonomik ose agjencionit të prokurimit për mbikëqyrje siç është ARP, ose KRPP. (Prokurimi Nr.: 450-10-02-521; 450-10-04-521; 450-10-05-521; 450-10-22-521; 450-1027-521; 450-10-40-521; 450-10-14-521; 200-10-30-121; 110-10-24-121; 300-10-25-121).

Aktiviteti i prokurimit është i iniciuar siç duhet, por nuk është lëshuar asnjë formë standarde “Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve”, që është e nevojshme të përgatitet para inicimit të çdo aktiviteti të prokurimit siç edhe kërkohet në nenin 8 të LPP. (Prokurimi Nr.: 450-10-02-521; 450-10-04-521; 450-10-05-521; 450-10-22-521; 450-1027-521; 450-10-40-521; 200-10-30-121; 110-10-24-121; 300-10-25-121).

Të gjeturat e vitit aktual (vijon)

Shpenzimet (vijon)

Është kërkuar nga operatorët ekonomikë të sigurojnë autoritetin Kontraktues me garancion të ekzekutimit në vlerë prej 10% të vlerës së kontratës së nënshkruar, siç është theksuar në nenin 60 të LPP. Periudha e kërkuar të mbulohet me garancion, duhet të jetë për një periudhë të një viti pas kryerjes së punëve. Kjo nuk është në përputhshmëri me Pjesën III. 2.2 të dokumenteve standarde të ofertimit që kërkojnë nga fituesi i tenderit të shpall, para se ta nënshkruaj kontratën, një garancion të ekzekutimit jo më pak se 10% e vlerës së kontratës në formën e cekur në dosje e tenderit. Tutje këtë praktikë, autoriteti kontraktues nuk ka mbuluar periudhën gjatë performancës së kontratës. (Nr. i prokurimit: 450-10-02-521; 450-10-04-521; 450-10-05-521; 450-10-22-521; 450-10-27-521)

Kemi vërejtur që gjatë vlerësimit të Asfaltimit të rrugëve “Krstec-Repçe” ne nr Re. 450-10-05-521, Komisioni Vlerësues ka bërë disa përmirësime aritmetike, por operatorët ekonomik nuk kanë qenë të informuar siç është kërkuar nga neni 29.8 i Rregullores B të Prokurimit dhe nenit 57.2 të LPP. Komunikimet jo të shkruara me operatorët ekonomik mund ta ekspozojnë autoritetin kontraktues ndaj çfarëdo kundërshtimi.

Për çdo projekt tre anëtar për pranim teknik janë caktuar, pasi që është kryer puna nga kontraktori. Kemi vërejtur që në dy aktivitete të prokurimit si anëtar për pranim teknik janë caktuar gjithashtu dy punonjës nga departamenti i prokurimit, që mund të shpie në konflikt të interesit, që do të thotë se punonjësit që kanë kryer procedura të prokurimit marrin pjesë në pranim teknik. Tutje, ata kanë diplomë të fakultetit në ekonomi dhe shkenca juridike por jo në fushë teknike. Komuna ka mungesë të personelit të kualifikuar në pranimet teknike të projekteve. (nr. i prokurimit: 450-10-05-521; 450-10-14-521).

Për secilin projekt, tre anëtar janë caktuar për mbikëqyrje të projektit. Ne kemi vërejtur që askush nga anëtarët e mbikëqyrjes së projektit është caktuar si kryetar i ekipit, që donë të thotë se mund të ketë risk në menaxhimin e projektit siç duhet, nëse nuk ka hierarki të duhur të përgjegjësive. Për më tepër, kemi vërejtur që Komuna ka mungesë të inxhinierëve të kualifikuar në mbikëqyrjen e projekteve.

Rreziku

Edhe pse gjetjet e lartpërmendura nuk kanë efekt material në pasqyrat financiare, mungesa e komunikimit në kohë dhe aprovimet nga autoritetet përkatëse ose dokumentacioni i pa kompletuar në dosjet e prokurimit mund të çojë tek mospërputhja me Ligjet dhe kërkesat e Rregulloreve.

Rekomandimi

Ne rekomandojmë Kryetarit që të sigurohet që Komuna të ndërmarrë hapa të përmirësimit të kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në përputhje me Ligje dhe kërkesat ligjore.

Të gjeturat e vitit aktual (vijon)

Komentet e Menaxhmentit

Përgatitjen e pagave mujore dhe shtesave e bënë Ministria e Shërbimeve Publike -Divizioni I pagave dhe kjo veprimtari nuk është në kompetence të komunës.

Pagesat e bëra nga pozicioni i subvencioneve për punëtorët të cilët kanë punuar jashtë orarit të punës në sezonin e pushimeve është bë nga shkaku se në Drejtoratin për administratë nuk ka pas mjete të mjaftueshme në pozicionin e pagave dhe tejkalimit të orarit për pagesën e kësaj shtese. Kodifikimi te pagesa e subvencioneve është bë në mënyrë të drejtë nga se DPT Dielli është person juridik po kështu është edhe për Sharrën. Në fakt pagesa e trungjeve është me destinim për personin individual por pagesa i bëhet personit juridik, andaj konsiderojmë se ky kodifikim është plotësisht i drejtë.

Prandaj, DPT Dielli dhe Sharra nuk janë persona fizik por entitete publike.

5 Auditimi i brendshëm

Të gjeturat

- Komiteti i Auditimit duhet të krijojë politika dhe procedura për të siguruar standardet e larta të qeverisjes.

Risku

Mungesa e operimit të Komitetit të Auditimit, rrit rrezikun e dështimit të kontrolleve të brendshme.

Rekomandim

Ne rekomandojmë qe Komuna të vendose politika dhe procedura për të siguruar një standard të lartë të udhëheqjes. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime si më poshtë:

- Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhmenti;
- Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të jenë të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore;
- Plani i auditimit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditimit të brendshëm.

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente.

Të gjeturat e vitit të kaluar

1 Përgatitja e Pasqyrave Financiare

Të Gjeturat

Informacioni parësor i besueshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është SIMFK. Komuna i regjistron pranimet dhe pagesat në Excel, që nuk janë përdorur për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet të pasqyrave financiare.

Megjithëse Kryetari i Komunës ka nënshkruar Deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka përgatitur një draft të pasqyrave financiare në gjuhën Angleze dhe Serbe para fillimit të auditimit tonë. Gjatë periudhës së auditimit ne shpenzuam kohe dhe burime të konsiderueshme në asistimin e Komunës për të përmirësuar prezantimin e pasqyrave financiare në gjuhën angleze. Sidoqoftë Komuna nuk ishte në gjendje të dorëzonte një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën Serbe në fund të auditimit tonë.

Për me tepër, informacioni në vijim që kërkohet të shpaloset në pasqyrat financiare nuk është i regjistruar në SIMFK dhe nuk është pjesë e një programi të integruar kontabiliteti:

- Pagesat nga palët e treta
- Faturat e pa paguara (detyrimet)
- Prona, objektet dhe pajisjet.

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet dhe detyrimet kontingjente. Si pasojë e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Neni 15. Asetet jo-financiare nuk është prezentuar në shënime
- Shënim 12 dhe 12.1. 'Të hyrat vetanake' dhe të hyrat nga administrata nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr 2009/20. Komuna nuk e ka kategorizuar burimin e vet të të hyrave të përcaktuara me udhëzim, por e ka përdorur kategoritë e saj të brendshme për të shpalosur këtë informacion. Shënim 12.1 që detajon më tej të hyrat nga taksat administrative, nuk ishte përfunduar. Megjithatë, detajet e kërkuara në Shënimin 12.1, janë shpalosur në Shënimin 12.
- Mund të ketë pagesa të konsiderueshme nga palët e treta, (për shembull kur një palë tjetër si një ministri apo donator i huaj blejnë/kontribuojnë një pasuri për përdorim nga Komuna), që nuk mund të regjistrohen në pasqyra financiare sepse nuk janë regjistruar në SIMFK;
- Neni 16, Shënimi 29 Detyrimi kontingjent nuk është i përfunduar.

Të gjeturat e vitit të kaluar (vijon)

2 Menaxhimi i pronave, objekteve dhe pajisjeve

Të Gjeturat

Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve në posedim të saj.

Në ishëm të pajisur me dëshmi të numërimit fizik të aseteve deri më 31 Dhjetor 2009. Megjithatë, ky numërim nuk ishte krahasuar me asnjë regjistër dhe përfshinte vetëm mobiliet dhe disa pajisje të tjera të vendosura në zyrat e ndërtesës kryesore të komunës, dhe nuk përfshinte prona si toka dhe ndërtesa. Gjithashtu Komuna nuk i ka vlerësuar asetet e numëruara në vlerën e drejtë, sepse matja e këtyre aseteve është bërë nga një komision i përbërë nga vlerësues jo të certifikuar.

Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë.

Për shkak të natyrës së të dhënave të tilla, Komuna nuk ishte në gjendje të:

- Shpalos informacionin mbi pronën, ndërtesat, dhe pajisjet në pasqyrat financiare me 31 Dhjetor 2009 dhe 31 Dhjetor 2008; dhe
- Të na siguroj të dhënat kontabël në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar në Kosovë
- Të sigurojë rikonsilimin e informacionit të regjistruar në regjistrat kontabël me tabelat e vlerësimit apo me ndonjë analize tjetër, përpara aprovimit të këtyre pasqyrave financiare.

Komuna mund të mos jetë në gjendje të kontrollojë shfrytëzimin momental të pasurisë së saj nga palët e treta dhe si pasojë mund të mos i mbledhë të hyrat nga qiraja nga këto patundshmëri.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve të saj dhe mungesës së vlerësimit të duhur të aseteve të saj, Komuna mund të mos jetë në gjendje të pajtohet me kërkesat për raportim.

3. Të hyrat

Të Gjeturat

- **Sistemi i faturimit.** Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për të hyrat nga tatimi në pronë. Për kategori tjera të të hyrave për të cilat sistemi i faturimit është i nevojshëm nuk është aplikuar. Vetëm arkëtimet nga të hyrat e tilla janë regjistruar.

Mangësitë në sistemin e faturimit. Gjatë vitit 2009 sistemi i faturimit i tatimi në pronë ishte centralizuar dhe komuna nuk mund të rishikojë dhe monitorojë në mënyrë të duhur mbledhjen e të hyrave siç ishte bërë në mënyrë automatike nga sistemi i ri. Mund të ndodh që konsumatori ka paguar tatimin në pronë, por shuma e grumbulluar nuk është regjistruar në sistem dhe klienti është ngarkuar me dënim (interes) edhe pse tatimi është paguar në kohë.

- **Mbledhja e të hyrave:** Përveç tatimit mbi pronën dhe lejeve të biznesit, Menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra të ndarë ose ndonjë listë të të gjithë borxhlinjve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Pa të dhëna të detajuara dhe të mjaftueshme të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë normë të saktë të mbledhjes ose të përcjellë në kohë mbledhjen e të hyrave vetanake burimore.
- **Të hyrat nga licencat e biznesit.** Komuna komunikon me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në mënyrë që të marr numrin e përgjithshëm të bizneseve të reja në komunë; këto biznese të

Të gjeturat e vitit të kaluar (vijon)

reja janë faturuar duke filluar nga viti në vijim. Komuna nuk ka azhurnuar listën ekzistuese për bizneset e ndërprera. Si pasojë, biznese joaktive ose të mbyllura mund të ngarkohen, ndërsa bizneset aktive apo të reja mund të mos ngarkohen me obligimin përkatës kur ato fillojnë operimin. Gjatë testimit të të hyrave nga licencat e biznesit, ne kemi gjetur se një pagesë për pranimin teknik dhe kushteve higjienike të objektit ishte përfshirë në të hyrat nga licencat e biznesit.

- **Të hyrat nga taksat administrative.** Gjatë vitit 2009 nga certifikatat e lindjes dhe martesës dëftesat përmbajnë numrat e njëjtë të brendshëm dhe numrat e njëjtë serik që i përkasin datave të ndryshme (rasti është me dëftesat me numrat e brendshëm 147-160. Ka dëftesa të dyfishuara, një palë prej tyre i përkasin muajit e mars dhe të tjera i takojnë muajit tetor).
- **Të hyrat nga participimet shëndetësore.** Komuna nuk ka kryer ndonjë kontroll në lidhje me mbledhjen e të hyrave nga participimet shëndetësore. Nuk është zbatuar participimi shëndetësor prej 0.30 euro nga barnat e listës esenciale siç është specifikuar në rregulloren e kuvendit komunal për taksat, gjobat dhe tarifata.

Ne nuk jemi pajisur me dëftesat origjinale nga participimet shëndetësore. Ne kemi marrë vetëm disa dëftesa për fundin e vitit 2008 dhe fillim e 2009, por jo të gjitha dëftesat që ishin zgjedhur për testim.

Janë mbledhur pagesat në para të gatshme mbi 10 euro, e cila është në kundërshtim me rregulloren e komunës ku është përcaktuar se pagesat mbi 10 euro duhet të paguhen në bankë (rasti është me certifikatat për leje të vozitjes).

- **Të hyrat nga tatimi në pronë.** Sipas një rregulloreje të tatimit në pronë, faturat për një vit kalendarik janë lëshuar brenda Marsit të atij viti. Ne kemi identifikuar aplikacionet për pronat të reja të regjistruara në 2009 ku Menaxheri i tatimit mbi pronën nuk e nënshkruan formularin e aplikimit. Si rezultat, shqyrtimi dhe miratimi i këtyre regjistrimeve nuk është dokumentuar si duhet.

4. Shpenzime

Të Gjeturat

Pagat dhe mëditjet

-Në rastet kur një mësues largohet nga puna, duhet së paku një muaj për tu njoftuar zyra e personelit dhe Ministria e Shërbimeve Publike në mënyrë që të reflektohen ndryshimet në listën e pagave. Bazuar në një vonesë të tillë, një mësues mund të marrë pagën edhe pas largimit të tij.

-Komuna nuk i mban të organizuara mirë dosjet e personelit. Për një nga punonjësit e zgjedhur për testim, neve nuk është siguruar dosja e tij për vitin 2009.

-Ka disa punonjës civilë të cilët janë gjithashtu anëtarë të kuvendit, ata po marrin paga dhe po ashtu pjesëmarrje në asamble e cila është në kundërshtim me ligjin e pushtetit lokal 03/L-040, neni 65.

Mallra dhe shërbime

Në artikujt që kanë qenë pjesë e mostrës sonë, komuna ka paguar shpenzimet në shumën prej 8,100 euro të dedikuara për arsimtarët, ndërsa janë paguar nga kodë 13620-Furnizim me ushqim për burgim, spitalet - nga Departamenti i Administratës.

